



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "OLTI SHPK" të datës 15.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT" me nr. të prokurimit 616-25-6970-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "OLTI SHPK" të datës 15.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT" me nr. të prokurimit 616-25-6970-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "OLTI SHPK" (tutje "parashtruesi") me datë 15.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i shkollave dhe IEA - BYFEJAT" me nr. të prokurimit 616-25-6970-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtresit janë cituar si në vijim:

"Heqja e kufizimit 60% për liderin e konsorciumit Dokumentet kërkojnë që lideri i konsorciumit të ketë të paktën 60% të vlerës së cakullimit. Ky kufizim përjashton konsorciumet ku ekspertiza është e shpërndarë në mënyrë të drejtë midis anëtarëve dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë për të përmbushur kontratën. Kërkojmë heqjen e këtij kufizimi, duke respektuar Nenit 7 të LPP-së (barazi dhe mosdiskriminim) dhe specifikimet teknike objektive (Neni 28 i LPP-së).

Heqja e kërkesës për transaksione bankare dhe pranimi i kontratave/referencave si dëshmi Kërkesa që operatori të dorëzojë transaksione bankare për çdo kontratë private nuk është e parashikuar nga ligji dhe paraqet pengesë të panevojshme për operatorët. Operatorët mund të japin kontratat dhe referencat e kryerjes së punëve, të cilat janë të mjaftueshme për vlerësimin e aftësisë dhe mund të verifikohet me fatura nga ATK. Kërkojmë që të hiqet kërkesa për transaksionet bankare dhe të pranohen kontratat dhe referencat si dëshmi e përvojës së operatorit.

Heqja e kërkesës për referencë specifike për ndërtimin e shkollave me dru Kërkesa që një inxhinier të ketë referencë specifike për ndërtimin e shkollave me dru është e panevojshme dhe diskriminuese".

Sa i përket pretendimit për heqjen e kufizimit 60% për liderin e konsorciumit dhe për heqjen e kërkesës për transaksione bankare dhe pranimi i kontratave/referencave si dëshmi, është gjetur se këto kërkesa janë absolutisht të domosdoshme për të siguruar përzgjedhjen e OE të përgjegjshëm i cili i përmbush kriteret e dhënies së kontratës mund të realizoj projektin në mënyrë efikase dhe efektive. Prandaj këto pretendime janë të pabazuara dhe kërkesat mbasin të pandryshuara.

Sa i përket pretendimit për heqjen e referencës specifike për ndërtimin e shkollave me dru, është gjetur se referencat specifike për ndërtimin e shkollave nga druri nuk janë në përputhje as me qëllimin e aktivitetit të prokurimit por as me vet kërkesën pasi që për secilin staf profesional është kërkuar që të prezantohen referenca si profesionist i fushës përkatëse prandaj nuk mund të kërkohej që përtej atyre referencave të prezantohet edhe një referencë specifike për ndërtimin e një projekti të caktuar sepse kjo do të ishte kërkesë e dyfishtë. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar dhe AK do të korrigjoj DT duke larguar kërkesat "se paku një reference për ndërtimin e shkollave me dru".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtresi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.